



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KANCELARI

Nr. 4133/1 prot

Tiranë, më 30.08.2024

Lënda: Njoftim për përfundimin e verifikimit paraprak të kandidatëve pjesëmarrës në fazën e lëvizjes paralele, për procedurën e rekrutimit, për pozicionin e kategorisë ekzekutive Specialist i teknologjisë së informacionit (IT), në Drejtorinë e Sigurisë dhe të Teknologjisë së Informacionit, në Gjykatën e Lartë, kategoria e pagës IV-1.

Në mbështetje të nenit 57 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 7 – 10, të kreut II dhe të neneve 23 e në vijim, të kreut IV, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe të udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor”, në përfundim të afatit kohor (**29.08.2024**) për dorëzimin e dokumentacionit për lëvizje paralele pranë Gjykatës së Lartë, për pozicionin Specialist IT, në Drejtorinë e Sigurisë dhe të Teknologjisë së Informacionit, ju bëjmë me dije se nuk ka pasur kandidatë të interesuar sipas procedurës “lëvizjes paralele”, që të plotësonin kërkesat e përgjithshme e të posaçme të vendeve të punës sipas shpalljes së publikuar.

Për rrjedhojë, sot më datë 30.08.2024, Kancelari në detyrë i Gjykatës së Lartë ju njofton se do të vijohet me procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin e kategorisë ekzekutive **Specialist IT në Drejtorinë e Sigurisë dhe të Teknologjisë së Informacionit, kategoria e pagës IV-1.**

Pas datës 05.09.2024, nga ana e Gjykatës së Lartë do të procedohet me njoftimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kandidatëve që kanë shprehur interesin e tyre për pjesëmarrje në fazën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin e mësipërm.

KANCELARI NË DETYRË

ANILA KULO